



## PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2011

### SESIONI II

(I DETYRUAR)

### SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

**VARIANTI A**

**Lënda: Letërsi dhe Gjuhë shqipe**

**Shkolla e mesme e gjuhëve të huaja**

*Udhëzime të përgjithshme:*

- Testi përbëhet nga dy pjesë.
- Testi përmban një total prej 50 pikësh.
- Testi ka 25 pyetje. 13 me zgjedhje dhe 12 me zhvillim.
- Për pyetjet me zgjedhje përgjigja e saktë vlerësohet me 1 pikë.
- Për pyetjet me zhvillim përgjigjet konsiderohen orientuese dhe në skemë parashikohen variantet e mundësive të përgjigjeve të nxënësve.
- Vlerësimi i pyetjes *ese* do të bëhet duke pasur parasysh rubrikat në tabelën e vendosur në fund të pyetjes dhe që është posaçërisht për vlerësuesit e testit.
- Pasaktësia gjuhësore ndikon negativisht në vlerësimin e nxënësit, në ato raste, kur ka përsëritje të theksuara gabimesh ose gabime të cilat prishin në mënyrë të vazhdueshme kuptimin e shprehjes.

**PJESA I****Ndre Mjeda****Andrra e jetës**

Pyetja 1	C	1 pikë
Pyetja 2	B	1 pikë
Pyetja 3	D	1 pikë
Pyetja 4	A	1 pikë
Pyetja 5	D	1 pikë
Pyetja 6	B	1 pikë

**Pyetja 7**                      **2 pikë****Model përgjigjeje**

- **Atmosfera:** Dimër, shkreti në natyrë, vetmi, ftohtësi.
- **Funksioni artistik:** një paraqitje e tillë e natyrës dhe mjedisit thekson vetminë, shkretinë e Lokes. Theksohet ana njerëzore.

**OSE**

- Autori vendos një paralelizëm (figurativ) mes natyrës dhe gjendjes shpirtërore dhe fizike të njeriut, për të theksuar këtë të fundit.

**1 pikë**                      Nëse përshkruan me pak fjalë atmosferën që zotëron në këtë fragment.

**DHE**

**1 pikë**                      Nëse tregon funksionin artistik të kësaj zgjedhjeje nga ana e autorit.

**0 pikë**                      Nëse përgjigjja e dhënë nuk i përmbahet thelbit të pyetjes ose nuk ka përgjigje.

**Pyetja 8**                      **2 pikë****Model përgjigjeje**

- Lokja i kërkon vdekjes vajzën që s'e ka më (Tringën).
- Ajo e kërkon pikërisht në këtë moment, pasi është në kulmin e dhimbjes dhe vetmisë. Plaga s'i është mbyllur edhe pas kaq kohe. Pra, theksohet pikërisht dhimbje e pangushëlluar dhe të mbeturit vetëm.

**1 pikë**                      Nëse tregon se çfarë i kërkon Lokja vdekjes.

**DHE**

**1 pikë**                      Nëse shpjegon arsyen e kësaj kërkesë.

**0 pikë**                      Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 9**                      **2 pikë****Model përgjigjeje**

- **Në kuptimin e drejtpërdrejtë:** zjarri është elementi i jetës, që na ngroh, jep gjallëri, na mbron nga i ftohti i dimrit.
- **Në kuptimin figurativ:** zjarri simbolizon ngrohtësinë familjare, shpresën, dashurinë, të cilat i mungojnë Lokes.

**1 pikë**                      Nëse shpjegon kuptimin e drejtpërdrejtë të fjalës *zjarr*.

**DHE**

**1 pikë**                      Nëse shpjegon kuptimin e figurativ të fjalës *zjarr*.

**0 pikë**                      Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 10**            **2 pikë****Model përgjigjeje**

- Ritmi i këtij fragmenti është i ngadaltë, si i zvarur, i qetë.
- Ky lloj ritmi është në funksion të idesë që përpiket të përçojë autori: një jetë që po përmbillet, pa forcë, pa gjallëri, pa ritëm, një jetë që po zvarritet drejt fundit.

**1 pikë**            Nëse përcakton ritmin e kësaj kënge.

**DHE**

**1 pikë**            Nëse shpjegon arsyen e kësaj zgjedhjeje.

**0 pikë**            Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 11 (a)**            **2 pikë****Model përgjigjeje**

- **Ndjesia:** Braktisje, heshtja që mbizotëron, një mjedis si në varreza, pa asnjë frymë njeriu rreth e rrotull.
- **Pjesa e ligjëratës:** mbiemra

**1 pikë**            Nëse tregon ndjesinë që i sugjerojnë fjalët e vargut.

**DHE**

**1 pikë**            Nëse gjen pjesën e ligjëratës.

**0 pikë**            Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 11 (b)**            **2 pikë****Model përgjigjeje**

- **Sinonimi:** e shuemja – e mjera, e gjora.
- Kjo fjalë mbart një ngarkesë të fortë emocionale, duke theksuar pikërisht të mbeturit pa asgjë, pa njerëz, pa shpresë, të varfër, të braktisur, të shuar nga jeta dhe dëshirat.

**1 pikë**            Nëse gjen sinonimin e fjalës.

**DHE**

**1 pikë**            Nëse shpjegon ngarkesën emocionale që mbart fjala.

**0 pikë**            Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 12**            **3 pikë****Model përgjigjeje**

- Në strofat 3, 4, 5 Lokja ëndërron. Ajo imagjiron një jetë të lumtur në pleqëri. Në ndryshim me strofat e tjera, ku mbizotëron vetmia dhe braktisja, në këto strofa, në kontrast, Lokja e shikon veten se si mund të kish qenë po të kish pasur një djalë.
- Janë strofa ku Lokja portretizohet e lumtur, në ndryshim me pjesët e tjera të këngës.
- Fjalët dhe shprehjet kyç që japin thelbin e këtij kontrasti janë:

*Me kry n'hi e shuemja plakë - Kish mbajtë zjerrmin ndezë mbi votër,*

*Me ndo 'j fëmi tu' e kalamendun - Përmbi vatër kush s'ia qet.*

*Vetun zbardh e vetun erret - Kish shkue motin si prendevra*

*Edhe Lokja me gjith' tjera / Kishte dalë me petka<sup>4</sup> n'shtat<sup>5</sup> - Nji dorë krande me i ba flakë /*

*Përmbi vatër kush s'ia qet*

OSE

*Hi- zjarr, Mbaruene lulet- prandevra, Kush s'ia qet- e reja, Vetun erret- fëmi, Etj*

**1 pikë**            Nëse shpjegon kontrastin midis strofave

**DHE**

**2 pikë**            Nëse gjen disa nga fjalët ose shprehjet që japin thelbin e këtij kontrasti (më shumë se një çift shprehjesh ose fjalësh).

**0 pikë**            Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 13**                      **8 pikë**

Për vlerësimin e esesë do të ndiqen kriteret e mëposhtme:

**KRITERI I: SHTJELLIMI I IDESË**                      **2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- shkruan një ese ku argumenton se për shumë njerëz jeta mbetet një ëndërr.
- shpjegon pse mendon se është e tillë.
- i mbështet idetë e veta me shembuj nga fragmenti ose vepra.
- përdor detaje mbështetëse.
- ka qartësi mendimi.

**KRITERI II: ORGANIZIMI DHE STRUKTURA E ESESË**                      **2 pikë****1 pikë**                      **Struktura e esesë**

- respekton elementet e strukturës së esesë:
  - hyrjen
  - zhvillimin
  - përfundimin

Nxënësi merr **1 pikë** nëse përgjigjen e dhënë e strukturon sipas skemës së mësipërme.

**1 pikë**                      **Organizimi i esesë**

- organizim logjik, ku shfrytëzohen teknika të tilla si koherenca dhe unifikimi i paragrafëve (lidhja logjike mes paragrafëve, kalimi në mënyrë të natyrshme).

**KRITERI III: STILI DHE ORIGJINALITETI**                      **2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- përmes gjuhës që përdor, krijon një përshtypje të përgjithshme për atë që do të shprehë.
- shprehet me një gjuhë eseistike.
- ka fjalor të pasur.
- stil origjinal.

**KRITERI IV: SAKTËSIA GJUHËSORE**                      **2 pikë****(1 pikë sintaksa dhe 1 pikë drejtshkrimi)**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- strukturon qartë përgjigjen nga pikëpamja gramatikore.
- ndërton fjali që janë të sakta dhe të qarta.
- përdor fjali që variojnë në modele, gjatësi dhe ritëm.
- ka saktësi drejtshkrimore.

**PJESA II****Viktor Hygo****Katedralja e Parisit**

Pyetja 14	D	1 pikë
Pyetja 15	A	1 pikë
Pyetja 16	D	1 pikë
Pyetja 17	B	1 pikë
Pyetja 18	A	1 pikë
Pyetja 19	A	1 pikë
Pyetja 20	C	1 pikë

**Pyetja 21 (a) 1 pikë**

**1 pikë** Në katedrale mbizotëron vetëm drejtësia hyjnore. Drejtësia njerëzore atje s'ka vend. Katedralja është vendi i perëndisë dhe vetëm ajo ka të drejtë të vendosë drejtësi atje.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 21 (b) 3 pikë**

**1 pikë** Të dy janë të mohuar nga shoqëria, të veçuar dhe të përbuzur prej saj. Kanë ngjashmëri shpirtërore.

**2 pikë** Kuazimodo po e shpëton Esmeraldën nga duart e drejtësisë, po e shpëton nga ndëshkimi për diçka që ajo nuk e ka bërë. Esmeralda e bën Kuazimodon më njerëzor, më të butë, më të dashur. E ndihmon të kuptojë se është njeri, me ndjenja dhe emocione. Të dy ndajnë mohimin dhe braktisjen që u është bërë.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

*Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një interpretim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.*

**Pyetja 22 (a) 2 pikë**

**1 pikë** **Figura e stilistikës:** metafora ose metaforë e hiperbolizuar.

**DHE**

**1 pikë** **Interpretimi:** Ashtu sikurse rrufeja lëshon shkrepitima dhe një dritë të fuqishme, edhe syri i Kuazimodos shkrepitinte duke i dëshmuar botës refuzimin e tij dhe këmbënguljen për ta mbrojtur deri në fund vajzën. Metafora e hiperbolizuar tregon pikërisht forcën e tij të jashtëzakonshme për ta mbrojtur Esmeraldën dhe për të *djegur*, ashtu si rrufeja, këdo që do guxonte ta prekte.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 22 (b) 2 pikë**

**1 pikë** **Gjendja shpirtërore:** *fatkeqe, i përbuzur, i madhërisëm, të fortë, etj.*

**DHE**

**1 pikë** **Pamja e jashtme:** *buçitës, e shëmtuar, të vrazhda, të ashpra, çipa- çipa, ciklopi, leshatake, etj.*

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 23**                    **2 pikë****Model përgjigjeje**

- Kuazimodo është një njeri i vrazhdë, i shëmtuar, me një forcë të jashtëzakonshme, por nga ana tjetër ai ka një shpirt të ndjeshëm, njerëzor. Pra një njeri kaq i përçudnuar ka një shpirt kaq bujar.
- **Ilustrimi:** *shprehte kësaj butësi, ëmbëlisi, dhembshuri - duke lëshuar shkrepitima, duarve të tij të vrazhda - por e mbante me aq kujdes, etj.*

**1 pikë**                    Nëse shpjegon kontrastin mbi të cilin ngrihet figura e Kuazimodos.

**DHE**

**1 pikë**                    Nëse gjen një ilustrim që tregon thelbin e këtij kontrasti.

**0 pikë**                    Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 24**                    **2 pikë****Model përgjigjeje**

- Kuazimodo po sfidon shoqërinë që e ka neveritur, mohuar, përbuzur, tallur e sflitur për kaq kohë. Ai po i tregon kësaj shoqërie se ai mund t'i dalë kundër dhe nuk e ka frikë aspak.
- Ai po triumfon mbi drejtësinë njerëzore, duke i rrëmbyer asaj Esmeraldën, duke mos e lënë ta ndëshkojë. Ai po triumfon mbi çdo gjë të padrejtë që kjo shoqëri përfaqëson.

**1 pikë**                    Nëse tregon ku qëndron sfida më e madhe e Kuazimodos.

**1 pikë**                    Nëse tregon se mbi çfarë po triumfon ai.

**0 pikë**                    Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 25**                    **2 pikë****Model përgjigjeje****Karakteristika të romantizmit:**

- shkrimi sugjestionues i Hygoit shkakton emocione të fuqishme përmes përshkrimeve;
- kthesat e befasishme;
- kontrastet e fuqishme;
- figurat e stilistikës të preferuara për romantikët si: *metafora, hiperbola, antiteza*;
- Etj.

**2 pikë**                    Nëse zbulon në fragmentin e dhënë dy karakteristika të romantizmit bashkë me ilustrimet përkatëse.

**OSE**

**1 pikë**                    Nëse zbulon në fragmentin e dhënë një karakteristik të romantizmit bashkë me ilustrimin përkatëse ose zbulon dy karakteristika por pa ilustrimet përkatëse.

**0 pikë**                    Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.